



## Asociacioni i Komunave të Kosovës

---

### RAPORT

<b>Për:</b>	<b>Ertan Munoglu – Menaxher i Programit</b>
<b>Nga:</b>	<b>Fisnik Dashi – Koordinator për Kolegjiume</b>
<b>Kopje:</b>	<b>Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv</b>
<b>Data :</b>	<b>18 prill 2011</b>
<b>Subjekti :</b>	<b>Raport nga takimi i Kryesisë së Kryesuesve të Kuvendeve Komunale</b>

#### HYRJE

Kryesia e Kolegjiut të Kryesuesve të Kuvendeve Komunale me datën 18 prill mbajti mbledhjen e rregullt të saj dhe të parën për vitin 2011.

Në këtë takim ishin prezentë z. Xhelal Gashi – Kryesues, z. Jakup Ternava - Zv. Kryesues, anëtarë z. Agim Aliu, z. Agim Aliu, z. Haki Taç dhe znj. Seylan Mazrek. Në takim po ashtu ishin prezent edhe z. Ertan Munoglu – Menaxher i Programit në AKK, dhe z. Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve në AKK.

Takimi kishte për qëllim fillimin e hartimit të Planit Vjetor të Punës për vitin 2011 të Kolegjiut të Kryesuesve të Kuvendeve Komunale dhe të përcaktoj listën e prioriteteve, objektivave, dhe aktiviteteve të Kolegjiut, si dhe mënyrën e lobimit për përmbushjen e prioriteteve të Kolegjiut.

## **PËRMBLEDHJE:**

Mbledhjen e hapi z. Xhelal Gashi me diskutimin e pikave të rendit të ditës:

- Përpilimi i planit të punës së kolegjiut
- Identifikimi i nevojave për trajnim
- Vizita nëpër Komunat e Kosovës për shkëmbim të përvojave
- Definimi i takimit të radhës së Kolegjiut
- Çështje tjera

Pas diskutimeve dhe debatit, Kryesia vendosi për këto prioritete dhe objektiva në realizimin e planit të punës së Kryesuesve të Kuvendeve Komunale në vitin 2011.

- Identifikimi i rregulloreve neper komuna, dhe shkëmbimi ne mes tyre;
- Amandamenti i LVL-se;
- Harmonizimi dhe standardizimi i akteve juridike komunale;
- Trajnim rreth teknikave te hartimit te akteve juridike;
- Komunikimi mes MAPL dhe KK.

Takimi kishte për objektiv edhe përcaktimin e pikave të rendit të ditës për takimin e radhës së Kolegjiut të Kryesuesve të Kuvendeve Komunale.

### **Takimi i radhës**

Kryesia për fund vendosi që takimi i Kolegjiut së Kryesuesve të Kuvendeve Komunale të mbahet të mërkurën me datën 11.05.2011 në Dragash.

Agjenda e takimit është përcaktuar si vijon:

1. Plotësimi i Kryesisë së Kolegjiut
2. Zhvillimi i modeleve të akteve juridike komunale
3. Takim me MAPL

Anëtarët ranë dakord që stafi i AKK-së të jetë përgjegjës për përgatitjen e ftesave, dhe sigurimit të ambientit ku do të mbahet mbledhja.